

## **Permbledhje mbi Programin Kombëtar për Kujdesin e Shikimit për Fëmijët**

Shikimi është një nga shqisat më të rëndësishme, i cili influencon në zhvillimin normal të kapaciteteve intelektuale e akademike të individit duke influencuar në këtë mënyrë potencialet zhvillimore të vendit e shoqërisë.

Vlerësohet se ka 1.4 milionë fëmijë të verbër në botë. 7 milionë të tjerë vuajnë nga shikimi i dobët dhe 10 milionë fëmijë të tjerë kanë te meta të refraksionit të korigjueshme.

Ekzaminimi i mprehtësisë pamore të fëmijëve në shkollë sipas një programi të caktuar, është edhe më efektiv dhe më pak i kushtueshëm sesa modelet e tjera të kujdesit parësor të syve kur bëhet fjalë për ofrimin i kujdesit për shendetin e syve për fëmijët që shkojnë në shkollë.

### **1. Përse zhvillohet ky program:**

Fëmijët e moshës shkollore përbëjnë një grup veçanërisht të ndjeshëm ku problemet me shikimin mund të kenë një ndikim dramatik në aftësitë e të mësuarit dhe potencialin arsimor. Shumica e fëmijeve në shkollë nuk e kuptojnë se vuajnë nga paaftësia për të parë pasi ato përshtaten me shikimin e dobët në mënyra të ndryshme. Fëmijët mund të mos e dinë ose të mos jenë në gjendje të shprehin se kanë probleme me shikimin përpara se të shkojnë tek mjeku specialist.

***Qëllimi kryesor i Programit Kombëtar për Kujdesin e Shikimit për Fëmijët është zbulimi dhe trajtimi i hershëm i problemeve të shikimit tek fëmijët, i domosdoshëm për të përballuar sfidat e verbërisë dhe pamjes se ulur ne fëmijëri.***

### **2. Implementimi i programit dhe vënia në zbatim.**

Në bazë të VKM-së me nr 246, më 20.04.2022 "Për miratimin e paketës së Programit kombëtar për Kujdesin e Shikimit për Fëmijët" u vu në zbatim programi kombëtar për shikimin me vizionin: "Parandalimi i verbimit dhe përmisimi i pamjes së ulur tek fëmijët për një të ardhme me sy të shëndetshëm".

Programi Kombëtar për Kujdesin e Shikimit për Fëmijët konsiston në kryerjen e testeve depistuese në shkollë për fëmijët 4-14 vjeç në të gjithë Shqipërinë.

Për moshat shkollore depistimi kryhet nga personeli shëndetësor/psikosocial të pranishëm në shkollë dhe nga mjekët e familjes në ato shkollë në të cilat nuk kanë personel shëndetësor.

Testi i depstimit kryhet me anë të ***tabelave të visusit*** sipas modelit të shkronjave të alfabetit, çdo vit për të gjithë nxënësit e klasave të 3-a,5-a,7-a dhe të 9-a.

Kohështrirja e procesit të depitimit është për gjatë gjithë vitit shkollor, Shtator deri më Qershor.

### 3. Dokumentimi dhe analizimi i të dhënave

Gjatë testeve të depistimit në shkolla, personeli shëndetësor që do të zhvillojë këtë proces të miratuar sipas Programit Kombëtar për Kujdesin e Shikimit për Fëmijët, duhet të dokumentojë zhvillimin e testit të depistimit.

Dokumentimi i këtij procesi do të bëhet bazuar në të dhënat individuale të nxënësit sipas një formati të caktuar si më poshtë :


Formati i plotësimit të dhënave të testit depistues të shikimit

Të dhënat demografike											Të dhënat për shikimin				
Nr	Data	Bashkia	Nj. Admini strative	QSH	2. Shkolla	3. Klasa	4. Emër	5. Mbiemër	6. Gjinia (M/F)	Ditelindje	8. A mban syze nxënësi PO/JO	9. Sa kohë ka që mban syze	10. Mprehtësia pamore e djathtë (Bazuar në tabelën e visusit)	11. Mprehtësia pamore e majtë (Bazuar në tabelën e visusit)	Rekomandime Mjeku ekzaminues

Pasi personeli shëndetësor ka përfunduar testin e depistimit, plotëson të dhenat në formatin e caktuar për nxënësit. Të dhënat do të plotësohen në tabelat përkatëse në mënyrë që të dërgohen/raportohen në institucionet përgjegjëse.

### 4. Raportimi i të dhënave dhe analizimi i tyre

Mbledhja e të të dhënave nga shkollat përkatëse sipas zonave, raportohen në Operatorin Rajonal Shëndetësor më pas në Ministrinë e Shëndetësive dhe Mirëqënies Sociale dhe në Insitutin Shëndetit Publik.



**Instituti i Shëndetit Publik** është përgjegjës për analizimin dhe interpretimin e databasave pas raportimit nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor.

Analiza e të dhënave bëhet bazuar në indikatorët:

- Përqindja e nxënësve të depistuar në raport me numrin total të nxënësve në shkollat e arsmimit 9-vjeçar bazë.
- Numri i nxënësve që rezultojnë me probleme të mprehtësisë pamore në raport me numrin e nxënësve të depistuar.
- Përqindja e nxënësve që janë rekomanduar tek specialisti në raport me numrin total të nxënësve të rezultuar me probleme të mprehtësisë pamore.

### **Rezultate të programit të depistimit**

*Për vitin akademik 2021-2022*, procesi i depistimit është zhvilluar për një pjesë të nxënësve të shkollave si rezultat i afatit të shkurtër kohor. VKM përkatëse e programit është hartuar më 20 Prill 2022 dhe depistimi ka filluar në Maj të këtij viti.

Gjatë kësaj periudhe të shkurtër kohore, janë depistuar rreth 82,700 nxënës (59% nga totali i nxënësve të klasave 3, 5, 7 dhe 9 të arsimit bazë), nga të cilët, 8,400 (10%) rezultojnë të jenë rekomanduar për vizitë okulistike tek specialisti.

*Për vitin akademik 2022-2023*, nga Shtatori 2022 deri më 8 Nëntor 2022, procesi i depistimit ka filluar në 368 shkolla (nga 1166 shkolla të arsimit bazë në Shqipëri) dhe totali i nxënësve të depistuar është 20,172.

Nga numri i nxënësve të depistuar deri më tani, kanë rezultuar 2,422 nxënës të rekomanduar tek specialisti.

Pas përfundimit të procesit të depistimit cdo viti akademik, do të bëhet analizimi i të dhënave për vitin shkollor dhe për rrjedhojë dhe raporti vjetor i detajuar.